



PROGRAMI I BURSIVE POLAKE “STEFAN BANACH” 2022

Agjencia Kombëtare e Shkëmbimit Akademik të Republikës së Polonisë (NAWA) në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Polonisë, ka shpallur hapjen e aplikimeve në kuadër të programit të bursave “Stefan Banach” për studime të ciklit të dytë për vitin 2022. Afatet e aplikimit për këtë bursë janë jo më vonë se data **31 mars 2022**, ora 3:00:00 pasdite me orën lokale Varshavë.

Ky program ofron studime të ciklit të dytë me bursë 1500 PLN afro 318 EUR në muaj përgjatë gjithë vitit akademik (3-4 semestra). Studimet përfshijnë fushat e mëposhtme:

a) shkencat inxhinieriko-teknike;

b) shkencat bujqësore;

c) shkencat e natyrës.

Opsionale mund të jenë edhe studime në shkencat humane dhe ato sociale ku bëjnë përjashtim studimet filologjike. Studimet mund të kryhen në gjuhën polake, ose angleze.

Bursa mbulon:

- a) 1700 PLN afro 361 EUR në muaj gjatë kursit përgatitor;
- b) 1500 PLN afro 318 EUR në muaj gjatë studimeve të ciklit të dytë.

Niveli i njohurive të gjuhës polake për aplikantët duhet të jetë:

- a) minimumi në nivelin A2 në rast se aplikanti planifikon fillimisht të fillojë kursin përgatitor njëvjeçar dhe pas kursit të vazhdojë shkollimin në ciklin e dytë të studimeve në gjuhën polake;
- b) minimumi B1 në rast se aplikanti planifikon të fillojë studimet e ciklit të dytë në gjuhën polake pa kurs përgatitor njëvjeçar;

ndërsa për gjuhën angleze së paku B2.

Aplikimi është i vlefshëm vetëm në formatin elektronik përmes **sistemit TIK të NAWA-s**, në gjuhën angleze dhe atë polake:

<https://programs.nawa.gov.pl/login>

Për më shumë informacion klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://nawa.gov.pl/en/students/foreign-students/the-banach-scholarship-programme/call-for-proposals>